



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori e thelluar

Varianti B

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	C	C	C	D	D	C	A	B	A

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11

Model përgjigjeje

- Ndarja e shoqërisë në dy klasa antagoniste të papajtueshme dhe në luftë midis tyre: borgjezia dhe klasa punëtore që Marks i quan proletariat në kuptimin e njerëzve të zhveshur nga mjetet e punës e të jetesës
- Lufta e klasave si forca lëvizëse e shoqërisë
- Revolucioni proletar i armatosur si forca më e lartë e luftës së klasave i konsideruar si mamia e shoqërisë së re
- Vendosja e diktaturës së proletariatit si shtet i tipit të ri
- Ndërtimi i shoqërisë së re socialiste dhe më pas komuniste
- Zhdukja e pronës private dhe vendosja e pronës shtetërore e kolektive

3 pikë nëse analizon tre nga idetë e marksizmit.

OSE

2 pikë nëse analizon dy nga idetë e marksizmit.

1 pikë nëse analizon një nga idetë e marksizmit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 12**Model përgjigjeje**

- Ata ishin të mirëinformuar për kolonizimin spanjoll të Filipineve, kështu që ardhjen evropianëve e konsideruan si hapi i parë në pushtimin e Japonisë
- Ekzistonte frika se të krishterët japonezë do t'i bindeshin vetëm kreut të kishës dhe jo shogunit
- Drejtuesit e shogunatit kishin frikën e kontaktit me perëndimorët që ishin më të përparuar në zhvillimin ekonomik. Për ta përvetësimi i teknologjive dhe ideve të reja do të minonte sundimin e tyre.

3 pikë nëse jep tre argumente të sakta për politikën izoluese të shogunatit Idehoishi.

OSE

2 pikë nëse jep dy nga argumentet e sakta për politikën izoluese të shogunatit Idehoishi.

1 pikë nëse jep një nga argumentet e sakta për politikën izoluese të shogunatit Idehoishi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 13**Model përgjigjeje**

- Kishin një territor dhe popullsi të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për një shtet
- Kishin financat, vulat dhe stemat e tyre
- Kishin një anministratë të drejtuar nga pashallarët si Ali Pashë Tepelena, Bushatllinjë etj.

3 pikë nëse shkruan tre argumente që tregojnë se pashallëqet shqiptare kishin tiparet e shtetit

OSE

2 pikë nëse shkruan dy nga argumente që tregojnë se pashallëqet shqiptare kishin tiparet e shtetit

1 pikë nëse shkruan një nga argumente që tregojnë se pashallëqet shqiptare kishin tiparet e shtetit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 14

- U ndalua poligamia
- U sanksionua martesat civile
- E drejta e divorcit

3 pikë nëse shkruan tre nga ndryshimet që solli Kodi Civil

OSE

2 pikë nëse shkruan dy nga ndryshimet që solli Kodi Civil

1 pikë nëse shkruan një nga ndryshimet që solli Kodi Civil

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

- Vetëm kisha mund të bënte shpjegimin dhe interpretimin e Biblës
- Besimi dhe punët e mira janë domosdoshmëri për shpëtimin e njeriut
- Ritualet kishtarë janë elementi thelbësor i besimit katolik
- Shërbimet fetare të kryhen në latinisht
- Papa është autoriteti më i lartë i kishës katolike

3 pikë liston tre nga vendimet e Koncilit të Trentos.

OSE

2 pikë nëse liston dy nga vendimet e Koncilit të Trentos.

1 pikë liston një nga vendimet e Koncilit të Trentos.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 16**Model përgjigjeje**

- Vazhdimi i Luftës së Ftohtë u përcaktua nga gjendjet ekonomike të dy superfuqive: SHBA: kishte një rënie ekonomike, ndonëse relative, ndërsa BS ishte zhytur në një krizë të thellë ekonomike. Në këtë mënyrë gara e armatimeve nuk mund të vazhdohej.
- Ndryshimet e thella që bëri Gorbaçov në politikën e jashtme. Ai u shpreh me ngulm për dhënien fund të garës së armatimeve dhe ndërhyrjes ushtarake në vende të tjera.
- Shpërbërja e bllokut komunist luajti rolin vendimtar në përfundimin e Luftës së Ftohtë.
- Rënia e Murit të Berlinit më 9 nëntor 1989, shënoi edhe rënien e simbolit kryesor të Luftës së Ftohtë.

4 pikë nëse analizon katër katorë që çuan në përfundimin e Luftës së Ftohtë

OSE

3 pikë nëse analizon tre nga katorë që çuan në përfundimin e Luftës së Ftohtë

2 pikë nëse analizon dy nga katorë që çuan në përfundimin e Luftës së Ftohtë

1 pikë nëse analizon një nga katorë që çuan në përfundimin e Luftës së Ftohtë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 17**Model përgjigjeje**

- a) Formimin e një besëlidhjeje, të njohur me emrin Lidhja Shqiptare e Lezhës, si një aleancë politike – ushtarake e princave shqiptarë rreth Skënderbeut. Kryetar u zgjodh Skënderbeu
- b) Krijimin e ushtrisë së Lidhjes me komandant të përgjithshëm Skënderbeun
- c) Krijimin e arkës për të përballuar shpenzimet e ushtrisë, me të holla nga kontributi i përbashkët i secilit bujar

3 pikë nëse rendit tre nga vendimet e Kuvendit të Lezhës

OSE

2 pikë nëse rendit dy nga vendimet e Kuvendit të Lezhës

1 pikë nëse rendit një nga vendimet e Kuvendit të Lezhës

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 18**Model përgjigjeje**

- a) Administratë – u krijua një administratë shqiptare, bashkëpunëtoresh me pushtuesin e huaj
- b) Ekonomi – u krye bashkimi doganor midis dy vendeve dhe në Shqipëri vërshoi kapitali italian
- c) Pavarësinë e saj – e humbi pavarësinë e saj dhe u kthye në një provincë italiane

3 pikë nëse i analizon tre pasojat e pushtimit italian

OSE

2 pikë nëse analizon dy nga pasojat e pushtimit italian

1 pikë nëse analizon një nga pasojat e pushtimit italian

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 19**Model përgjigjeje**

- Qytetet mesjetare ishin të fortifikuara, rrethoheshin me mure të larta 2-3 m me bedena, me porta të forta e ura të lëvizshme
- Qytetet mesjetare nuk u shkëputën përfundimisht nga bujqësia, pra ishin gjysmëbujqësore ku banorët kishin bahçe, bagëti, vreshta etj.
- Sëmundjet epidemike dhe zjarret ishin të pranishme.
- Qytetet mesjetare ishin të larmishme nga shtresat e poullsisë.
- Veprimtaria kryesore ekonomike e qyteteve mesjetare ishte tregtia dhe zejtaria.
- Qytetet mesjetare vetëqeveriseshin.

2 pikë nëse rendit dy prej tipareve të qyteteve mesjetare

OSE

1 pikë nëse rendit një prej tipareve të qyteteve mesjetare

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 20**Model përgjigjeje**

Në aspektin politik sipas kushtetuts së vitit 1946 Shqipëris shpallej Republikë Popullore dhe pushteti buronte nga populli, ndërsa në kushtetutën e vitit 1976 Shqipëria shpallej Republikë Popullore Socialiste, një shtet i diktaturës së proletariatit; kushtetuta e vitit 1976 shpallte luftën e klasave si forcë lëvizëse në vend etj.

Në aspektin ekonomik sipas kushtetutës së vitit 1976 njihej prona shtetërore, private e kooperativiste etj, ndërsa në kushtetutën e vitit 1976 ekonomia e RPSH shpallej ekonomia socialiste që mbështetej te prona socialiste dhe kryesisht në forcat e veta

Në aspektin e të drejtave të njeriut, sipas kushtetutës së vitit 1946 garantohej barazia para ligjit, liria e ndërgjegjes dhe e besimit. Feja ishte e ndarë nga shteti dhe komunitetet fetare do të ishin të pavarura.

Ndërsa sipas kushtetutës së vitit 1976 kishte disa nene që sanksiononin mohimin e të drejtave të njeriut. Më i rëndësishëm ishte ai i mohimit të së drejtës së besimit dhe ndërgjegjes. Kështu Shqipëria shpallej shtet ateist, i vetmi në botë si i tillë.

Model përgjigjeje

3 pikë nëse bën krahasime të sakta me të paktën një element krahasimi në aspektin politik, ekonomik dhe të të drejtave të njeriut

OSE

2 pikë nëse bën krahasime të sakta me të paktën një element krahasimi në dy nga aspektet

1 pikë nëse bën krahasime të sakta me të paktën një element krahasimi në një nga aspektet

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare